



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 26.08.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.08.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "BRT&REXHA" për aktivitetin: <"Rregullimi i ambientit për ekspozimin e veprave të artit"> dhe me numër të prokurimit: 616 -19-121-521 nxjerr:

### V E N D I M

Miratohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "BRT&REXHA" e datës 23.08.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit <"Rregullimi i ambientit për ekspozimin e veprave të artit">, me nr.616 19 121 521 kundër *Njoftimit të Vendimit për dhënje të kontratës të AK –së*, të datës 21.08.2019, të publikuar në Platformën elektronike E Prokurimi të KRPP-së.

1. **Anulohet *Njoftimi i Vendimit për anulim të aktivitetit* i publikuar me datë: 21.08.2019 dhe aktiviteti kthehet në rivleresim;**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "BRT&REXHA" me datë 23.08.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: <"Rregullimi i ambientit për ekspozimin e veprave të artit"> me Nr.616 19 121 521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 26.08.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar drejt sipas nenit 59 dhe 60 të LPP-ik është plotësisht i bazuar pasi që është verifikuar se peshkrimi i çmimit që është dhënë nga Autoriteti Kontraktues në formatin Exel ka pas gabime, respektivisht në totalin e formatit nuk është peshirë shuma e çmimeve në disa nentotale dhe si rezultat i të njejtës janë paarqitur korigjimet në çmimin total. Pra të gjitha gabimet e paarqitura

aritmetike janë rezultat i gabimeve në formatin e dhënë nga AK-ja dhe jo rezultat i gabimeve aritmetike të tenderuesit.

Bazuar në këto gabime aritmetike duhet të pranohen dhe tenderuesi të trajtohet si i përgjegjshëm dhe aktiviteti kthehet në rivlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit duke u bazuar në konstatimet paraprake ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, pretenduesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



Vendimi u dërgohet:

- Palës ankuese (nëpërmes Platformes elektronike);
- Njësisë së kërkesës;
- Departamentit të Prokurimit; dhe
- Anëtarëve të komisionit